



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .10.2024

MBLEDHJA Nr. 38,
Datë 07.10.2024, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 07.10.2024, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 38 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35KV.
2. Mbi procedurën e hapur me vendimin e Bordit të ERE me nr. 79, datë 02.05.2024, “Mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë DRAGOBIA ENERGY sh.p.k.”.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “TEODORI” sh.p.k. për për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Zalli i Bulqizës” dhe Hec “Ternovë”.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “ERSEKA SOLAR PARK 1” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “DELTA PLAN STUDIO” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “ORHER” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
7. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
8. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.01.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Drita”, me kapacitet të instaluar 1980 kW, i ndryshuar.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI